

**AKT THEMELIMI**  
**PËR SHOQËRINË TREGTARE**  
**“MARS JULIAN” SH.P.K. FIER**

Sot më datë 01 / 02 / 2006 ne ortakët themelues :

1. ALFRED FERKO, biri i Nuri-ut dhe Behie-s, i datëlindjes 11.06.1966, lindur e banues ne Fier, shtetas shqiptar ;
  2. GENCI NUSHI, biri i Petraq-it dhe Vasilike-s, i datëlindjes 20.08.1968, lindur e banues ne Fier, shtetas shqiptar ;
  3. DUAN SULEJMANI, biri i Mazar-it dhe Nimete-s, i datelindjes 24.12.1967, lindur e banues ne Fier, shtetas shqiptar ;
- me dëshirën dhe vullnetin tonë të plotë, në mbështetje të ligjës nr.7638 dt. 19.11.1992 " Për Shoqëritë Tregëtare " dhe nr.7667 dt. 28.1.1993 " Për rregjistrimin në rregjistrin tregëtar ", vendosëm që të formulojmë këtë akt për themelimin e një shoqërie tregëtare private me përgjegjësi të kufizuar ( sh.p.k. ) si më poshtë vijon :

**NENI 1.**

Shoqeria **“3-SH” Sh.p.k.** themelohet si Shoqëri Tregtare, bazuar në ligjin Nr.7638 datë 9.11 .1992 “Për Shoqëritë Tregtare”.

Ajo është Person Juridik Privat Shqiptar.

Selia e saj ndodhet në adresën :

**Lagja “1 Maj” Nr. 65, Fier.**

**NENI 2.**

Veprimtaria e Shoqërisë bazohet në normat e këtij akti themelimi, statutit të shoqërisë, si dhe Legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Themeluesit e saj mbajnë përgjegjësi vetëm për detyrimet që krijon Shoqëria.

**NENI 3.**

Kapitali themelitar i shoqërise është i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë.



Kuotat e Shoqërisë janë të ndara si më poshtë :

1. **Alfred Ferko**, me cilësinë e ortakut themelues, zotëron 56 % të kuotave të kapitalit themeltar.
2. **Genci Nushi**, me cilësinë e ortakut themelues, zotëron 39 % të kuotave të kapitalit themeltar.
3. **Luan Sulejmani**, me cilesine e ortakut themelues, zoteron 5 % te kuotave te kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar është investuar nga Ortakët Themelues, në gjithë madhësinë e tij dhe në masën 100 % të vlerës së kapitalit, në përpjestim me pjesët e tyre takuese.

Vlerësimi dhe shlyerja e kapitalit themeltar është bërë nga Ortakët Themelues me rastin e miratimit të kësaj kontrate themelimi dhe është nënshkruar prej tyre.



#### **NENI 4.**

Shoqëria ka të depozituar në Banke kapitalin në të holla, i cili depozitohet në llogarinë "Shoqëri në Formim e Sipër" dhe në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate themelimi.

Mbas regjistrimit të Shoqërisë kjo shumë do të kalojë në llogarinë e kësaj Shoqërie.

#### **NENI 5.**

Shoqëria do të ketë si objekt të përgjithshëm të veprimtarisë së saj:

- ◆ Import-eksport dhe tregetim me shumice e pakice të mallrave të ndryshëm ushqimorë e industriale. Kufizohen në këtë pjesë të objektit vetëm mallrat tregëtimi i të cilave kërkon liçence të veçante.
- ◆ Ambalazhim i produkteve ushqimorë.
- ◆ Shërbime të ndryshme si bar-bufë, restaurant, hoteleri, shërbime parukerie etj.
- ◆ Transporti i mallrave me mjetet e shoqërisë si për vetë dhe për të tretë.

#### **NENI 6.**

Shoqëria do të funksionojë me një afat kohor mbi 10 vjet.

Afati i fillimit të veprimtarisë fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Rregjistrin Tregtar.

#### **NENI 7.**

Ortakët themelues mund të heqin dorë nga Shoqëria, por gjithnjë për shkak të përligjura.

Heqia dorë nuk i shkarkon ortakët nga detyrimet e Shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë.

#### **NENI 8.**

Investimet dhe veprimtaria e Shoqërisë gezojnë mbrojtjen e shtetit Shqiptar, i cili krijon të njëjtat kushte si për subjektet shqiptare ashtu edhe ato të huaja.

#### **NENI 9.**

Fitimi i realizuar kalon në pronësi të ortakëve themelues.

Fitimi është lirisht i transferueshëm brenda edhe jashtë shtetit shqiptar.

#### **NENI 10.**

Ortakët Themelues kanë sidomos këto detyrime:

Të regjistrojnë Shoqërinë në Rregjistrin Tregtar dhe të marrin lejet e nevojshme të ushtrimit të aktivitetit të veprimtarisë së tyre.

Të derdhin kapitalin e nevojshëm për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë.

Të sigurojnë mjediset e nevojshme për fillimin e aktivitetit, makineritë, materialet e para e ndihmëse.

- Të sigurojnë mundësitë e specializimit të fuqisë punëtore dhe specialistëve për zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë.

- Të sigurojnë objektet dhe makineritë e Shoqërisë nga çdo lloj dëmtimi.

- Të menaxhojnë prodhimin e ta reklamojnë atë nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informacionit.

#### **NENI 11.**

**Organet drejtuese të Shoqërisë janë :**

- Asambleja e Ortakëve.

- Administratori.


- Ekspertët Kontabël për rastet e parashikuara nga ligji.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë **"3-SH" Sh.p.k.** do të jetë **Genci Nushi.**

#### **NENI 12.**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë.

A handwritten signature in black ink is located in the bottom right corner of the page. Below the signature is a circular stamp containing the number '3'.

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.


### NENI 13.

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga Ortakët themelues të Shoqërisë dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

### NENI 14.

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues u nënshkrua prej tyre pa vërejtje para Noterit të vendit të themelimit të Shoqërisë.

### ORTAKËT THEMELUES

  
Alfred Ferko  
Genci Nushi  
Luan Sulejmani

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ZYRA E NOTERISE FIER

Nr. 1066/Regj. 12011 Kol.

Fier me 18.2.2006

### VERTETIM NENSHKRIMI

Une notere Adelina PANAJOTI, notere ne Fier, vertetoj se akti i mesiperme eshte firmosur me vullnetin e tyre te lire nga shtetasit :

- 1 – ALFRED FERKO, biri i Nuri-ut dhe Behie-s, i datëlindjes 11.06.1966, lindur e banues ne Fier, shtetas shqiptar, identifikuar nga pasaporta nr. Z0638120 ;
  - 2 – GENCI NUSHI, biri i Petraq-it dhe Vasilike-s, i datëlindjes 20.08.1968, lindur e banues ne Fier, shtetas shqiptar, identifikuar nga pasaporta nr. 1854802 ;
  - 3 – LUAN SULEJMANI, biri i Mazar-it dhe Nimete-s, i datëlindjes 24.12.1967, lindur e banues ne Fier, shtetas shqiptar, identifikuar nga pasaporta nr. Z0638120 ;
- që te tre madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Akti firmoset edhe nga une noterja.



NOTERE  
ADELINA PANAJOTI

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË TREGTARE "3-SH" SH.P.K.**  
**ME SELI NË FIER**

Sot më datë 01.02.2006 ne Ortakët Themelues :

1. **ALFRED FERKO** ..... shtetas shqiptar ;
2. **GENCI NUSHI** ..... shtetas shqiptar ;
3. **LUAN SULEJMANI** ... shtetas shqiptar

në mbështetje të Aktit të Themelimit datë 01/02/2006, miratojmë këtë Statut mbi karakterin dhe veprimtarinë e shoqërisë tregëtare me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), i cili konsiston si më poshtë vijon :

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Shoqëria Tregtare rregullon pozitën e saj juridike, marrdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin nr.7638 date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrdhëniet e Shoqërive Tregtare.

**NENI 1.**

**Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë :**

- ◆ Import-eksport dhe tregëtim me shumice e pakice të mallrave të ndryshëm ushqimorë e industriale. Kufizohen në këto pjesë të objektit vetëm mallrat tregëtim i të cilave kërkon liçence të veçante.
- ◆ Ambalazhim i produkteve ushqimorë.
- ◆ Sherbime të ndryshme si bar-bufë, restaurant, hoteleri, sherbime parukerie etj.
- ◆ Transporti i mallrave me mjetet e shoqërisë si për vete dhe për të tjerë.


**NENI 2**

**Emri dhe selia e Shoqërisë**

Shoqëria është Person Juridik Privat.

Shoqëria do të paraqitet në qarkullim me emrin e saj **"3-SH" Sh.p.k.**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën : Lagja "1 Maj", Nr.65 - Fier.



### **NENI 3.**

#### **Regjimi Juridik i Shoqërisë.**

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin.

Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të aktit të themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi.

Me vendim të ortakëve, Shoqëria mundet që të ndryshojë rregjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e aktit të themelimit dhe të statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

## **II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE.**

### **NENI 4.**

Ortakët mbajnë përgjegjësi për humbjet deri në kufirin e kapitalit të investuar.

Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Ortakëve, në raport me përqindjet e kapitalit themelues që ata zoterojnë. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qera, të lihen peng e ipotekë me miratimin e ortakëve themelues.

### **NENI 5.**

#### **Të drejtat e Ortakëve.**

- Të administrojnë aktivitetin e shoqërisë konform objektit të veprimtarisë së saj duke përfshirë edhe veprimtarinë prodhuese e tregtare që shoqëria mund të kryejë si dhe vlerat e saj intelektuale e ekonomiko-financiare.
- Te marrin dijeni për rezultatet ekonomiko-financiare në çdo fazë të aktivitetit të saj.
- Te marrin pjesë vetë ose me anë të përfaqësuesit në këtë aktivitet.
- Të tërheqin të gjithë dokumentat kryesore të shoqërisë për tre vitet e fundit.
- Te marrin nga Administratori i Shoqërisë 15 ditë para çdo mbledhje asambleje materialet e saj dhe projektet e vendimeve.
- Të heqin dorë nga Shoqëria dhe mund të shesin pjesën e kapitalit të tyre, në përputhje me kushtet që i lejon Statuti dhe Ligji. Heqia dorë nga shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që kanë deri në momentin e heqies dore dhe nuk i cënon ata në marrjen e të ardhurave, në proporcion me pjesën e tyre, që Shoqëria ka siguruar deri në këtë moment. Në rastin e heqies dorë ata mund të ofrojnë pjesën e tyre të kapitalit ortakëve të tjerë, në bazë të së drejtës së



Handwritten signature and stamp, likely representing the Administrator or a representative of the company.

parablerjes dhe me refuzimin nga ana e tyre mund t'ja ofrojne kete pjese cdo personi tjetër te mundshem.

#### **NENI 6.**

##### **Ortakët kanë edhe këto detyrime kryesore :**

- Të depozitojnë pjesën e tyre në kapitalin e Shoqërisë brenda afatit të parashikuar.
- Të derdhin kuotat suplementare në kushtet e përcaktuara në statut.
- Të përpiqen për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.
- Të informojnë organet drejtuese të Shoqërisë për mundësitë e përmirësimit të aktivitetit të saj.
- Të marrin pjesë në procesin e rritjes së nivelit të specialistëve.
- Të respektojnë detyrimet që burojnë nga akti i Themelimit.

#### **NENI 7.**

##### **Kohëzgjatja e Shoqërisë.**

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me një afat mbi 10 vjet.

### **III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË.**

#### **NENI 8**

Veprimtaria e funksionimit të Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut.

Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe paqyrohet në bilancet e saj.

#### **NENI 9**

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues në vlerën 100.000 (njëqindmijë) lekë.

Kuotat janë me vlere nominative. Kapitali themeltar ndahet në kuota me shuma jo më të vogla se 1000 lekë.

Kuotat e Shoqërisë janë të ndara si më poshtë :

- 1. Alfred Ferko**, me cilësinë e ortakut themelues, zotëron 56% të kuotave të kapitalit themeltar.
- 2. Genci Nushi**, me cilësinë e ortakut themelues, zotëron 39% të kuotave të kapitalit themeltar.
- 3. Luan Sulejmani**, me cilësinë e ortakut themelues, zotëron 5% të kuotave të kapitalit themeltar.

#### **NENI 10**

##### **Trasferimi i kuotave tek pasardhësit, parardhësit dhe bashkëshorti.**

Kuotat e Ortakëve mund të transferohen lirisht tek trashgimtarët ligjore e testamentarë të tij mbas vdekjes si dhe tek bashkëshorti tjetër në rastin e zgjidhjes së martesës.

A handwritten signature in black ink is located at the bottom right of the page. Below the signature is a circular stamp, partially obscured, which appears to contain the name 'ALFRED FERKO' and some other illegible text.

#### **NENI 11.**

##### **Forma e transferimit**

Transferimet e kapitalit themelor duhet të vërtetohen me akt noterial, ndryshe janë të pavlefshme. Në të gjitha rastet e transferimit të kapitalit themeltar nevojitet miratimi paraprak i ortakëve të shoqërisë

#### **NENI 12.**

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali themelor mund të zmadhohet ose të zvogëlohet kur për këtë vendosin Ortakët themelues.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve.

#### **NENI 13.**

Ortakët themelues, vendosin për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

#### **NENI 14.**

##### **Fondet rezerve**

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike. Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerien e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

#### **NENI 15.**

##### **Përdorimi i të ardhurave neto.**

E ardhura neto që rezulton mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloj aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kredinë për investime, pagat e shpërblimet, përdoret nga Ortakët, sipas qëllimit të tyre.

#### **NENI 16.**

##### **Bilanci**

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë.

Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.





## **NENI 17**

### **Plani financiar.**

Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri.

Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

## **IV. ORGANET E SHOQËRISË.**

### **NENI 18.**

Organi themelor i shoqërisë është Asamblea e Ortakëve. Asambleja e ortakëve, është e zakonshme dhe e jashtëzakonshme. Mbledhja e jashtëzakonshme mund të mbledhet në çdo kohë kur vetë ortakët e shikojnë të nevojshme.

Asamblea e Ortakëve vendos për të gjitha problemet me përjashtim të atyre që është vendosur ndryshe nga Statuti.

Asamblea e Ortakëve mbledhet të paktën një herë në vit për miratimin e bilancit, mbasi lajmërohet nga Administratori 15 ditë përpara me shkrim.

Asamblea e Ortakëve drejtohet nga Administratori. Ai emëron nga pjesëmarrësit një sekretar për mbajtjen e proces - verbalit të mbledhjes me përjashtim të fasteve kur ai duhet mbajtur nga një Noter sipas ligjit.

Vendimet e mbledhjes fiksohen në proces-verbalin e firmosur nga Administratori dhe sekretari ose Noteri. Në proces-verbal duhet të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur me kërkesën e bërë prej tij, deklaratat e bëra prej Ortakëve. Vendimet e mbledhjes, të marra në përputhje me ligjin, aktin e themelimit ose Statutin janë të detyrueshme për ortakët, megjithëse nuk kanë diskutuar ose kundërshtuar.

## **V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**


### **NENI 19.**

Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga Administratori.

Administratori ka të gjitha të drejtat e fuqitë për drejtimin e zakonshëm të Shoqërisë, me qëllim që të arrijnë objektivat e saj, përveç atyre që ligja ja atribuon Ortakëve.

Administratori përfaqëson Shoqërinë në mardhënie me të tretët si dhe para organeve të administratës dhe atyre gjyqësore.

Shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e organit administrativ. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për dëme të kryera gjatë administrimit. Administratori shkarkohet me vendim të Ortakëve. Përveç kësaj Administratorët mund të shkarkohet nga Gjykata me kërkesë të njerit prej Ortakëve.

A handwritten signature in black ink is located at the bottom right of the page. Below the signature is a circular stamp containing the number '5'.

Ortakët kanë të drejtë që të marrin nga Administratori të dhëna për zhvillimin e punëve dhe të shikojnë librin e Shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë "3-SH" Sh.p.k. do të jetë **Genci Nushi**.

#### **NENI 20**

Administratori ka këto kompetenca kryesore :

- Të miratojë planet e llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre dhe t'i paraqesin ato sipas rastit për miratimin përfundimtar Asamblesë së Ortakëve.
- Të bëjë propozimet përkatëse Ortakëve kur lind nevoja për ndryshime në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- Të miratojë aktet normative që përcaktojnë raportet në gjirin e Shoqërisë duke përfshirë kuadrin e personelin.
- Të përfaqësojnë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët.
- Të përcaktojnë strukturën e aparatit të Shoqërisë dhe të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të Shoqërisë.
- T'i propozojë ortakëve për krijimin e njërive, strukturave të ndryshme si filiale, degë e përfaqësi në qytete të tjera të vendit ose jashtë shtetit.
- Të përgatisi propozimin për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe t'ja paraqesi ortakëve për miratim.
- Të përzgjedhë ekspertët kontabël dhe anëtarët e komisionit të likuidimit si dhe të paraqesi propozimet për miratim para Asamblesë së Ortakëve.
- Të sigurojë zbatimin e përpiktë të Vendimeve të Asamblese së Ortakëve.
- Të përcaktojnë numrin e punonjësve në Shoqëri.

#### **NENI 21.**

##### **Ekspertët Kontabël.**

Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo vit financiar kur jemi përpara rasteve të përcaktuara në ligj. Caktimin e tyre e bën Mbledhja e Ortakëve.

Ekspertët kontabël mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullt të të gjithë dokumentacionit të Shoqërisë.

Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë Shoqërisë nga mbajtja e parregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesit, administratori, personat që janë gjini e krushqi me ata deri në shkallën e katërt. Po ashtu nuk mund ta kryejnë këtë detyrë përgjegjësit e zyrave, filialeve e agjensive.


#### **VI. MARRDHËNIET E PUNËS.**

##### **NENI 22.**

Marrdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të aktit të themelimit, statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.

Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontrates individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve.

Marrdhëniet midis Shoqërisë e sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.



### **NENI 23.**

Kontrata individuale e punës rregullon këto marrdhënie:

- Marrja në punë dhe kushtet e të punësuarit për tu marrë në punë.
- Llojin e punës që do të kryejë i punësuarit, profesionet ndihmëse, koha e punës ditore e javore, pushimi ditor e javor, shpërblimi për kohën e punës, për periudhën jashtë kohës normale të punës, për punën e natës, për ditët e pushimit dhe të festave, shpërblimi për punë të dalluar.
- Përgjegjësitë e palëve për mosrespektimin e kontratës.

### **NENI 24.**

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrative janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht.

## **VI. MBYLLJA E SHOQËRISË. LIKUJDIMI.**

### **NENI 25.**

Veprimtaria e Shoqërisë mund të ndërpritet para afatit kur Shoqëria nuk rezulton rentabël gjatë dy vjetëve të fundit radhazi dhe kur për këtë vendos Gjykata kompetente.

### **NENI 26.**

Kur vendoset shkrirja e Shoqërisë, mbi propozimin e Administratorit, Mbledhja e Asamblesë të Ortakëve cakton likuidatorin që realizon likuidimin e saj. Shoqëria gjatë likujdimit mban anash emërtimit edhe emrin "Shoqëri në Likujdim e Sipër".

Me miratimin e likujdimit Shoqëria i jep fund veprimtarisë.

### **NENI 27.**

Asambleja e Ortakëve vendos mbi rregullshmërinë e likujdimit, për të vendosur për bilancin e likujdimit dhe heqjen e mandatit të likuidatorit.

Asambleja e Ortakëve mund të kërkojë edhe vetë realizimin e kësaj mbledhje, në rast se likuidatori nuk e kërkon. Mbledhja vendoset edhe nga Gjykata mbi propozimin e njërit prej Ortakëve ose të një mandatmbajtësi.

### **NENI 28.**

Kur Asambleja e Ortakëve, pa shkaqe të arsyeshme nuk vendos për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata mbylljen e likujdimit.

Aktet e mbylljes së likujdimit, së bashku me llogaritë përkatëse përfundimtare, depozitohen në regjistrin tregtar.

Mbas mbylljes së likujdimit e depozitimit të dokumentacionit në regjistrin tregtar, Shoqëria çregjistrohet prej tij.



## VII. DISPOZITA TË FUNDIT.


### NENI 29.

Nëpunësit, të zgjedhurit nga Asamblea e Ortakëve, e personat që punojnë për llogari të saj, mbajnë përgjegjësi penale e civile sipas nenit 296, 297, 301 të ligjit "Për Shoqëritë Tregtare" kur me dashje shkelin detyrat e ngarkuara e i shkaktojnë humbje Shoqërisë.

### NENI 30.

Statuti hyn në fuqi mbas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

### ORTAKËT THEMELUES

- 
- 1- Alfred Ferko
  - 2- Genci Nushi
  - 3- Luan Sulejmani

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ZYRA E NOTERISE FIER

Nr. 186E Regj 12/11 Kol.

Fier me 18.2.2006


### VERTETIM NENSHKRIMI

Une notere Adelina PANAJOTI, notere ne Fier, vertetoj se akti i mesiperm eshte firmosur me vullnetin e tyre te lire nga shtetasit :

- 1 – ALFRED FERKO, biri i Nuri-ut dhe Behie-s, i datëlindjes 11.06.1966, lindur e banues ne Fier, shtetas shqiptar, identifikuar nga pasaporta nr. Z0638120 ;
- 2 – GENCI NUSHI, biri i Petraq-it dhe Vasilike-s, i datëlindjes 20.08.1968, lindur e banues ne Fier, shtetas shqiptar, identifikuar nga pasaporta nr. 1854802 ;
- 3 – LUAN SULEJMANI, biri i Mazar-it dhe Nimete-s, i datëlindjes 24.12.1967, lindur e banues ne Fier, shtetas shqiptar, identifikuar nga pasaporta nr. Z0638120 ;

qe te tre madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Akti firmoset edhe nga une noterja.



NOTERE :  
ADELINA PANAJOTI



*Adelina Panajoti* 8